



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

## Njoftim publik

Nr. 05-015/02-104370/24, Nr. 05-015/02-104371/24, Nr. 05-015/02-104374/24, Nr. 05-015/02-104376/24  
Nr. 05-015/02-104369/24, Nr. 05-015/02-0104367/24, Nr. 05-015/02-104364/24

Drejtoria e Urbanizmit – Komuna e Prishtinës, ka filluar procedurën me numër nr. 05-015/02-104370/24, nr. 05-015/02-104371/24, nr. 05-015/02-104374/24, nr. 05-015/02-104376/24, nr. 05-015/02-104369/24, nr. 05-015/02-0104367/24, nr. 05-015/02-104364/24 përmes së cilës kërkohet caktimi i adresave nga aplikuesi “Marigona Hill” shpk., dhe ka bërë propozimin për emërtim të këtyre rrugëve në ZK.Hajvali.

Agjencia Kadastrale e Kosovës e ka digjitalizuar (si rrugë të reja) segmentet e rrugës që shtrihet në këtë hapësirë, ndërsa Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës duke u bazuar në kërkesën e lartcekur si dhe Neni 2, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, Vendimin 01 nr. 031 -223419, dt. 02.10.2015 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe Neni 5, Neni 6, pika 1.1.16., Neni 7, pika 1, pika 2, pika 3., 3.1., dhe pika 3.3., të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPHI – së, i ka dhënë këtyre rrugëve kodet të veçanta (kodi 19\_15008, 19\_15009, 19\_15011, 19\_15012, 19\_15013 dhe 19\_15014) dhe ka bërë propozimin për emërtim e këtyre rrugëve. Emrat e propozuara janë:


1. “Urani Rumbo” (1895 - 1936) ka qenë veprimtare për të drejtat e gruas shqiptare dhe dramaturge.
2. “Vorea Ujko” ( 1918-1989) ishte një shkrimtar arbëresh nga Kalabria e Italisë.
3. “Ura Vajgurore” është një qytet në Rrethin e Beratit në Shqipëri.
4. “Thoma Kacori”,(1922-2008) shkencëtari dhe shkrimtari, profesori dhe intelektual.
5. “Teodor Keko” ( 1958 - 2002) ka qenë shkrimtar dhe publicist shqiptar.
6. “Pjetër Gjoka” ( 1912- 1982) ka qenë aktor i njohur shqiptar.
7. “Zef Harapi” ( 1891- 1948) ishte një shkrimtar.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 29.08.2024 deri më 16.09.2024, në E-mail adresën: [urbanizmi@rks-gov.net](mailto:urbanizmi@rks-gov.net)

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPHI –së, për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtim, listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal, neni 7, paragrafët 1, 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në web-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në web-faqe të Komunës. Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë si dhe kodi i rrugës përkatëse.



Nënshkrimi i Zyrtares:



Komuna e Prishtinës  
Drejtoria e Urbanizmit  
Adresa: rr. “Radovan Zogoviq” nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë  
Telefon: + 383 (0) 38 221 242  
e-mail: [urbanizmi@rks-gov.net](mailto:urbanizmi@rks-gov.net)